



Data: 01.04.2019

Ref.: 543/19 D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 65-të, të mbajtur më 13 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.373/19H, datë 11.02.2019 e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik, si e bazuar.
- II. Anulohet vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.179/19D, datë 11.02.2019.
- III. Aprovohet aplikacioni i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Ekonomik, për riakreditim të programeve të studimit, Marketing, BSc, 180, dhe Marketing, MSc, 120 ECTS.

Arsyetimi

Me qëllim të plotësimit të kriterëve formale për staf akademik sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), KSHC bazuar në pikën 2.1. Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018) dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), në mbledhjen e 63-të, mbajtur më 27 shkurt 2019, vendosi që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të iu lejohet/pranohet riorganizimi i stafit akademik bartës të programeve, të deklaruar në afatin kohor të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018).

KSHC me vendim Nr.179/19D, datë 11.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, Marketing, BSc, 180, dhe Marketing, MSc, 120 ECTS.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.178/19D, datë 11.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë 3 mars 2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit


të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Përmes kësaj ankesa, Universiteti ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth staf akademik për programin e studimit i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KShC-së Nr.179/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 65-të të KShC-së, të mbajtur me 13 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë